



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



## KONTRATË

Numri i kontratës <sup>1</sup>: 626-21-3518-1-3-6/C95

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe

Operatori Ekonomik Multi Business Group SH.P.K. me numër të biznesit: 811033258 Selia në Prizren, Rruga Mazllum Kastrati, të cilën me autorizim e përfaqëson z. Ardijan Besimi në cilësinë e Administratorit të O.E. (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

**“FURNIZIMI DHE MONTIMI I TABELËS INFORMUSE SI DHE TRUPAVE NDRIQUES TË SHKOLLËS FILLORE ANADOLU NË MAMUSHË”-Ritender me numër identifikues të prokurimit: 626-21-3518-1-3-6 dhe numër të brendshëm: 626-21-010-1-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate është furnizimi me tabelë ndriçuese me mbishkrim dhe trupa ndriçuese për objektin e SHFMU ANADOLU si dhe objektet e Komunës së Mamushës nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME				
” FURNIZIMI DHE MONTIMI I TABELËS INFORMUSE SI DHE TRUPAVE NDRIQUES TË SHKOLLËS FILLORE ANADOLU NË MAMUSHË”				
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	
1.	Furnizimi dhe montimi i tabelës informuese e cila do të përmbajë emrin dhe logon e shkollës si dhe logon e shtetit, logon e Republikës së Kosovës. Shkronjat duhet të ngjyrosen me ngjyrë të bardhë, kurse sipërfaqja e tabelës me ngjyrë të kuqe. Tabela duhet të punohet nga materiali alkabond (Aluminium Composit) DIM. 820 CM X 140 CM dy logo rrethore plexiglass 3d+pvc 75cm bazë alumini e kuqe e errët. Teksti: Republika e Kosovës, Kosova Cumhuriyeti (plexiglass +pvc foljo dim.600cmx30cm) Teksti: Ilk ve orta alt okulu- shkolla e mesme e ulët mamuša (plexiglass +pvc folja dim.560cmx30cm) Shkronjat e emrit "ANADOLU" (Pexiglass 3d 59 cm) Ndriçimi tabelës: dy logo, sipërfaqja 600cmx30cm, sipërfaqja 560cmx30cm dhe të gjitha shkronjat duhet furnizohen me ndriçim LED 12 v samsung ose baras vlershme. Shih skicën e bashkangjitur. Me garancion 2 vite.	Copë	1.00	
2.	Furnizimi dhe vendosja e trupave ndriçues me panele LED të cilat duhet të montohen në tavanin (pllakën) me beton, me dimensione 30x30, me fuqi 24W, me parametrat 3000K, 24W, 1920LM, 220-240V Në formën rrumbullakët.	Copë	150.00	
3.	Furnizimi dhe vendosja e trupave ndriçues me panele LED të cilat duhet të montohen në tavanin (pllakën) me beton, me dimensione 60x60, me fuqi 24W, me parametrat 6000K, 36W, 4500 LM, 220-240V Në formën katrore.	Copë	150.00	

Vërejtje: Tabela e dorëzuar informuese duhet të ketë garancion së paku 2 vite edhe për montimin e saj, por edhe për funksionalizimin e saj.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

## **Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **15** ditë nga koha e porosisë nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Vendi kryesor i dorëzimit është Objekti SHFMU "ANADOLU" dhe Objektet e Administratës të Komunës Mamushës.**

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetë Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>3</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar)..

## **Neni 3 Çmimi**

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **4,400.00 €; Katërmijë e katërqind Euro.**

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

## **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7 Garancioni**

7.1 **Operatori Ekonomik duhet të ofroj materialet e kualitetit të lartë të përshkruar sipas specifikacionit teknik të cekur në Dosjen e Tenderit. Në rast të konstatimit të ndonjë të metë të mallit nga njësia e pranimit Operatori Ekonomik është i detyruar që mallin ta zëvendësoj me mall pa të metë. Për tabelën e shkollës fillore të cekur në pozicionin nr. 1, me tenderin e tij O.E. ka dorëzuar edhe garancionin e nënshkruar dhe të vulosur i cili është i vlefshëm për një periudhë prej 2(dy) viteve nga data e pranimit teknik.**

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

<sup>3</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



## Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike në pajtim me ligjin e Kosovës.

## Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ardijan Besimi	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Administrator	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	22.07.2021	Data:	22.07.2021
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO


MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS  
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA




Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: "FURNIZIMI DHE MONTIMI I TABELËS INFORMUESE TË SHKOLLËS FILLORE ANADOLU NË MAMUSHË"-Ritender

Nr i prokurimit	626-21-3518-1-3-6
Nr i brendshëm	626-21-010 -1-3-6

SPECIFIKIMET MINIMALE TEKNIKE TË DETYRUESHME					
Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	<p>Furnizimi dhe montimi i tabelës informuese e cila do të përmbaj emrin dhe logon e shkollës si dhe logon e shtetit, logon e Republikës së Kosovës. Shkronjat duhet të ngjyrosen me ngjyrë të bardhë, kurse sipërfaqja e tabelës me ngjyrë të kuqe. Tabela duhet të punohet nga materiali alkabond (Aluminium Composit ) DIM. 820 CM X 140 CM dy logo rrethore plexiglass 3d+pvc 75cm bazë alumini e kuqe e errët. Teksti: Republika e Kosovës, Kosova Cumhuriyeti (plexiglass +pvc foljo dim.600cmx30cm) Teksti: İlk ve orta alt okulu- shkolla e mesme e ulët mamuşa (plexiglass +pvc folja dim.560cmx30cm) Shkronjat e emrit "ANADOLU" (Pexiglass 3d 59 cm) Ndriçimi tabelës: dy logo, sipërfaqja 600cmx30cm, sipërfaqja 560cmx30cm dhe te gjitha shkronjat duhet furnizohen me ndriçim LED 12 v samsung ose baras vlershme. Shih skicën e bashkangjitur. Me garancion 2 vite.</p> 	Copë	1	200	200
2.	<p>Furnizimi dhe vendosja e trupave ndriçues me panele LED të cilat duhet të montohet në tavanin (plakën) me beton, me dimensione 30x30, me fuqi 24W, me parametrat 3000K, 24W, 1920LM, 220-240V Në formën rumbullakët.</p>	Copë	150	8	1200
3.	<p>Furnizimi dhe vendosja e trupave ndriçues me panele LED të cilat duhet të montohet në tavanin (plakën) me beton, me dimensione 60x60, me fuqi 24W, me parametrat 6000K, 36W,</p>			20	3000

4500 LM, 220-240V Në formën katrore.	Copë	150	
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet e aplikueshme ne vendin tonë			4400

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
<b>EMRI I KOMPANISË</b>	MULTI BUSINESS GROUP SHPK
<b>ADRESA E PLOTE</b>	MAZLLUM KASTRATI PN, PRIZREN
<b>PËRFAQËSUAR NGA:</b>	
<b>EMRI &amp; MBIEMRI</b>	JETON BYTYQI
<b>POZITA</b>	DREJTOR
<b>NËNSHKRIMI</b>	
<b>DATA</b>	16.06.2021
<b>VULA</b>	

